

ANEKSI 32-01

**Dorëzania e Garantuesit — Garancia individuale**

I. Dorëzania e garantuesit

1. I nënshkruari (<sup>1</sup>).....

banues në (<sup>2</sup>).....

garanton personalisht dhe solidarisht këtu,

në zyrën e garancisë së .....

deri në një shumë maksimale prej.....

në favor të Republikës së Shqipërisë, Kosovës, Bashkimit Evropian që përfshin Mbretërinë e Belgjikës, Republikën e Bullgarisë, Republikën Çeke, Mbretërinë e Danimarkës, Republikën Federale të Gjermanisë, Republikën e Estonisë, Republikën e Greqisë, Republikën e Kroacisë, Mbretërinë e Spanjës , Republikën Franceze, Irlandën, Republikën Italiane, Republikën e Qipros, Republikën e Letonisë, Republikën e Lituanisë, Dukatit e Madh të Luksemburgut, Hungarisë, Republikën e Maltës, Mbretërinë e Holandës, Republikën e Austrisë, Republikën e Polonisë, Republikën e Portugalisë, Rumaninë, Republikën e Sllovenisë, Republikën e Sllovakisë, Republikën e Finlandës, Mbretërinë e Suedisë, Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore, Republikën e Islandës, ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Mbretërinë e Norvegjisë, Konfederatën Zvicerane, Republikën e Turqisë,

çdo shumë për të cilën personi që e jep këtë garanci (<sup>3</sup>).....

mund të jetë ose të bëhet përgjegjës në R.Sh për borxhin në formën e detyrimit doganor dhe pagesave të tjera (<sup>4</sup>) në lidhje me mallrat e përshkruara më poshtë nën një nga operacionet doganore të mëposhtme (<sup>5</sup>):

<sup>1</sup> Mbiemri dhe emri ose emri i firmës

<sup>2</sup> Adresa e plotë

<sup>3</sup> Mbiemri dhe emri ose emri i firmës dhe adresa e plotë e personit që siguron garancinë

<sup>4</sup> E zbatueshme për pagesat e tjera në lidhje me importin ose eksportin e mallrave ku garancia përdoret për vendosjen e mallrave nën regjimin e transitit/proçedurën e transitit të përbashkët

<sup>5</sup> Plotëso me një nga operacionet e mëposhtme doganore:

(a) Magazinim i përkohshëm;

(b) Regjimi transiti /procedurë e transitit të përbashkët ;

(c) Regjimi i magazinimit doganor;

(ç) Regjimi i lejimit të përkohshëm me përjashtim të plotë nga detyrimi i importit;

(d) Regjimi i përpunimit aktiv;

(dh) Regjimi i përdorimit të veçantë përfundimtar (end-use) ;

(e) Çlirim për qarkullim të lirë nën një deklaratave doganore standarte pa shtyrje pagese;

(ë) Çlirim për qarkullim të lirë nën një deklaratave doganore standarte me shtyrje pagese;

.....  
Përshkrimi i mallrave:.....

2. I nënshkruari merr përsipër të paguajë në bazë të kërkesës së parë me shkrim të zyrës doganore kompetente dhe pa mundur të shtyjë pagesën përtej një periudhe 30 ditore nga data e aplikimit të shumës së kërkuar, përveç nëse ai ose ajo ose çdo person tjetër i interesuar provon përpara skadimit të këtij afati, siç kërkohet nga autoritetet doganore, që regjimi i posaçëm përveç regjimit të përdorimit të veçantë përfundimtar (end-use) është mbyllur, që mbikqyrja doganore e mallrave të regjimit të përdorimit të veçantë përfundimtar (end-use) ose magazinimi i përkohshëm është mbyllur në mënyrë korrekte ose, në rast të operacioneve të ndryshme nga regjimet e posaçme dhe nga magazinimi i përkohshëm, situata e mallrave është rregulluar.

Me kërkesë të nënshkruarit dhe për çdo arsye të pranuar si të vlefshme, zyra doganore kompetente mund të shtyjë përtej një periudhe 30 ditore nga data e aplikimit për pagesë, afatin në të cilin ai ose ajo është i detyruar të paguajë shumën e kërkuar. Shpenzimet e lindura si rezultat i miratimit të kësaj periudhe shtesë, në veçanti çdo interes, duhet të llogaritet që shuma të jetë ekuivalente me atë që do të tarifohej në rrethana të ngjashme në tregun e parasë dhe atë financiar kombëtar.

3. Kjo dorëzani është e vlefshme nga dita e miratimit të saj nga zyra e garancisë. I nënshkruari është përgjegjës për pagesën e çdo borxhi të lindur gjatë operacioneve doganore të mbuluara nga kjo dorëzani, e cila ka filluar përpara datës së hyrjes në fuqi të revokimit ose anulimit të garancisë, edhe në qoftë se kërkesa për pagesë është bërë pas kësaj date.

4. Për qëllim të kësaj dorëzanie, i nënshkruari jep adresën e tij ose të saj të shërbimit në secilin prej shteteve në përputhje me pikën 1 <sup>(6)</sup>

Shteti	Mbiemri dhe emrat, emri i shoqërisë dhe adresa e plotë
--------	--

- (f) Çlirimi për qarkullim të lirë nën një deklaratë doganore të depozituar në përputhje me nenin 152 të Kodit;  
(g) Çlirimi për qarkullim të lirë nën një deklaratë doganore të depozituar në përputhje me nenin 165 të Kodit Doganor;  
(gj) Rregjimi i lejimit të përkohshëm me përgjashtim të pjesshëm nga detyrimi importit;  
(h) Në qoftë se ka tjetër — trego llojin tjetër të operacionit.

<sup>6</sup>Nëse, në legjisllacionin e një shteti, nuk ka një dispozitë për adresë shërbimi, dorëzanësi do të caktojë, në këtë shtet, një përfaqësues të autorizuar për të marrë çdo lloj komunikimi që i adresohet atij dhe njoftimi sipas nënparagrafit të dytë dhe dorëzania sipas nënparagrafit të katërt të paragrafit 4, të parashikuar në Aneksin 32-01 të VKM nr.446/2017, duhet të bëhen që të korrespondojnë. Gjykatat e shteteve ku ndodhen adresat e shërbimit të dorëzanësit ose të agjentëve të tij do të kenë jurisdiksion në rast mosmarrëveshje në lidhje me këtë garanci.


I nënshkruari pranon se e gjithë korrespondenca dhe njoftimet dhe çdo formalitet ose procedurat në lidhje me këtë dorëzani të adresuara atij/asaj ose të bëra në adresë të tij/saj për shërbimet do të pranohet si e dorëzuar në mënyrë të rregullt.

I nënshkruari pranon juridiksionin e gjykatës në vendin ku ai ose ajo ka një adresë për shërbim.

I nënshkruari merr përsipër të mos ndryshojë adresën e tij ose të saj për shërbim ose, në qoftë se ai ose ajo duhet të ndryshojë një ose shumë nga ato adresa, duhet të njoftojë më parë zyrën e garancisë.

E kryer në.....  
më.....

(Nënshkrimi) <sup>(7)</sup>

## II.Miratimi nga zyra e garancisë

Zyra e garancisë.....

Dorëzania e dorëzanësit e miratuar në ..... për të mbuluar operacionin doganor të bërë me deklaratën doganore /deklaratën e magazinimit të përkohshëm nr. ....

.....i..... <sup>(8)</sup>

(Vula dhe Nënshkrimi)

<sup>7</sup> Personi që nënshkruan dokumentin, përpara nënshkrimit të tij ose të saj duhet të shkruajë me shkrim dore si më poshtë:

'Garanci për shumën e ...' (shuma shkruhet me fjalë).

<sup>8</sup> Për t'u plotësuar nga zyra ku mallrat ishin vendosur nën regjim ose në magazinim të përkohshëm.